



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave dhe Inspektimit

Treguesit Statistikor të Tregut të Shërbimeve Postare

Tremujori 1 2026

Referenca: AKEP Statistika Shërbime Postare T1 2026

Data e publikimit: 25.05.2026

<https://akep.al/publikime/statistika/te-dhenat-dhe-treguesit-e-sherbimeve-postare/>

Rruga “Reshit Çollaku”, Tiranë, Tel: ++355 4 2259 571 www.akep.al, info@akep.al

Përmbajtje

1 . HYRJE	3
2. Treguesit dhe tendencat kryesore.....	3
3.Treguesi të Shërbimit Universal Postar	7
4.Tregues të shërbimit jo-universal postar (Ekspres dhe Jo-Ekspres)	8
Aneks 1: Numri i Objekteve postare sipas ofruesve të shërbimit postar	10
Aneks 2: Terma dhe shkurtime dhe përshkrimi i treguesve.....	11

1. Hyrje

AKEP mbledh të dhëna periodike statistikore nga ofruesit e shërbimeve postare në Shqipëri, bazuar në përcaktimet e Ligjit Nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”, e ndryshuar (Rregullore 40/2015).

Ky dokument është përgatitur nga AKEP bazuar në të dhënat e raportuara nga Posta Shqiptare (PSH) dhe Ofruesit e Tjerë të Shërbimeve Postare (OTSHP), për Tremujorin e parë të vitit 2026 (T1 2026) sipas formularëve përkatës të Rregullores 40/2015.

Dokumenti në vijim përmban përshkrim të tendencave kryesore të tregut postar sipas llojeve kryesore të shërbimeve dhe objekteve postare (Seksioni 2), ecurinë dhe strukturën e objekteve postare të shërbimit universal të ofruar nga Posta Shqiptare (Seksioni 3), ecurinë dhe strukturën e objekteve postare të shërbimit jo-universal postar (Seksioni 4). Në Aneks 1 AKEP ka paraqitur informacion për numrin e objekteve postare të 25 ofruesve të shërbimit postar që kanë raportuar të dhënat statistikore për T1 2026, ndërsa Aneksi 2 përmban disa shënime për përshkrimin e treguesve dhe mënyrën e matjes së tyre me referenca në formularët e Rregullores 40/2015.

2. Treguesit dhe tendencat kryesore

Treguesit dhe Tendencat Kryesore Shërbimi Postar T1 2026			
	Volumi i Përgjithshëm Shërbimeve Postare (SHU+Jo-SHU)	Shërbimi Postar Universal (SHU)	Shërbimi Postar Jo-Universal /Jo-SHU (Ekspres + Jo-Ekspres)
 Objekte Postare Total	6.8 milionë (+0.3% v. T4 2025 / +22% v. T1 2025)	4.4 milionë (+1.1% v. T4 2025 / +1.7% v. T1 2025)	2.4 milionë (-1.2% v. T4 2025 / +31% v. T1 2025)
 Objekte postare Brenda vendit (Domestic)	5.8 milionë (-1% v. T4 2025 / +23% v. T1 2025)	4.3 milionë (+2% v. T4 2025 / +20% v. T1 2025)	1.5 milionë (-10% v. T4 2025 / +33% v. T1 2025)
 Objekte postare Ndërkombëtare, prej të cilave:	970 mijë (+11% v. T4 2025 / +14% v. T1 2025)	99 mijë (-26% v. T4 2025 / -43% v. T1 2025)	872 mijë (+18% v. T4 2025 / +28% v. T1 2025)
 Dalëse (Outbound):	59 mijë (-27% v. T4 2025 / -82% v. T1 2025)	25 mijë (-48% v. T4 2025 / -6% v. T1 2025)	34 mijë (+5% v. T4 2025 / -88% v. T1 2025)
 Hyrëse (Inbound)	911 mijë (+15% v. T4 2025 / +72% v. T1 2025)	74 mijë (-14% v. T4 2025 / -49% v. T1 2025)	837 mijë (+18% v. T4 2025 / +118% v. T1 2025)
 Posta Shqiptare:	4.6 milionë brenda vendit (+2% v. T4 2025 / +21% v. T1 2025) 105 mijë ndërkombëtare (-25% v. T4 2025 / -41% v. T1 2025)	4.71 Milion Objekte Postare Total (+1% v. T4 2025 / +18% v. T1 2025) 94% objekte postare SHU 6% objekte postare Jo-SHU (3% Ekspres +3% Jo-Ekspres)	79% objekte të thjeshta 21% objekte të regjistruara/ shërbime shtesë
 OTSHP-të:	1.22 milionë brenda vendit (-11% v. T4 2025 / +35% v. T1 2025) 865 mijë ndërkombëtare (+18% v. T4 2025 / +28% v. T1 2025)	2.1 Milion Objekte Postare Total (-1% v. T4 2025 / +32% v. T1 2025) 67% objekte postare Ekspres 34% objekte postare Jo-Ekspres	 92% objekte postare Pako  8% objekte postare Letra

Volumi i përgjithshëm i shërbimeve postare

Volumi i përgjithshëm i shërbimeve postare të ofruar nga Posta Shqiptare (në vijim, PSH) dhe Ofruesit e Tjerë të Shërbimeve Postare (në vijim, OTSHP) në T1 2026 ishte rreth 6.8 milion objekte postare, që përbën një rritje me 0.3% në krahasim me T4 2025 dhe 22% në krahasim me T1 2025.

Numri i objekteve postare brenda vendit ishte 5.8 milion duke shënuar një rënie me -1% në krahasim me T4 2025 dhe rritje me 23% në krahasim me T1 2025.

Numri i objekteve postare ndërkombëtare (dalëse + hyrëse) arriti në 970 mijë duke shënuar rritje të konsiderueshme prej 11% në krahasim me T4 2025 dhe 14% rritje në krahasim me T1 2025:

- **Numri i objekteve postare ndërkombëtare dalëse** ishte rreth 59 mijë objekte, që përbën një rënie me 27% në krahasim me T4 2025 dhe 82% në krahasim me T1 2025.
- **Numri i objekteve postare ndërkombëtare hyrëse** arriti në rreth 911 mijë, që përbën një rritje me 15% në krahasim me T4 2025 dhe rritje me 72% në krahasim me T1 2025.

Shërbimi Universal postar

Ofruesi i Shërbimit Universal: *Posta Shqiptare sh.a.*

Volumi i përgjithshëm i Shërbimit Universal (në vijim SHU) shënoi rritje me 1.1% krahasuar me T4 2025 dhe me 17% në krahasim me T1 2025 duke arritur në 4.4 milion objekte postare SHU në T1 2026:

- 4.3 milion objekte postare SHU brenda vendit: rritje me 2% krahasuar me T4 2025 dhe 20% krahasuar me T1 2025;
- 99 mijë objekte postare SHU ndërkombëtare (dalëse + hyrëse): rënie të ndjeshme me 26% krahasuar me T4 2025 dhe rënie prej 43% në krahasim me T1 2025.

Struktura e objekteve postare të SHU në T1 2026:

- 98% postë brenda vendit dhe 2% postë ndërkombëtare: +/- 0.82pp përkatësisht në krahasim me T4 2025.
- 79% objekte postare të thjeshta dhe 21% objekte të regjistruara: +/- 1.6 pp përkatësisht në krahasim me T4 2025.

Raporti (pesha) i numrit total të objekteve të SHU ndaj numrit total të objekteve të shërbimit postar të ofruar nga PSH dhe OTSHP-të në T1 2026 ishte 65% duke shënuar rënie me -2.42 pp krahasuar me T1 2025:

- 75% e objekteve postare brenda vendit ishin objekte postare SHU: rënie me 1.84 pp në krahasim me T1 2025;
- 10% e objekteve postare ndërkombëtare ishin objekte postare SHU: rënie me 10 pp në krahasim me T1 2025 (43%);

Shërbimi postar jo-universal (Ekspres dhe Jo-Ekspres)

Ofruesit e Shërbimit Jo-Universal (Ekspres dhe Jo-Ekspres): *Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Tjerë të Shërbimit Postar (OTSHP) sipas Regjistrimit të Autorizimit të Përgjithshëm.*

Volumi i përgjithshëm i shërbimit postar jo-universal (Jo-Ekspres + Ekspres) në T1 2026 ishte 2.4 milion objekte duke shënuar një rënie me 1.2% në krahasim me T4 2025 por rritje me 31% kundrejt T1 2025, prej të cilave:

- 1.6 milion objekte të shërbimit ekspres (rënie me 2% në krahasim me T4 2025 dhe me 1% në krahasim me T1 2025).
- 798 mijë objekte të shërbimit jo-ekspres (rritje me 1% në krahasim me T4 2025 dhe me 264% në krahasim me T1 2025), dhe

Numri i objekteve postare brenda vendit Jo-SHU (Jo-Ekspres + Ekspres) në T1 2026 ishte 1.48 milion objekte duke shënuar rënie me 10% në krahasim me T4 2025 dhe rritje 33% në krahasim me T1 2025, ndërsa **numri i objekteve postare ndërkombëtare Jo-SHU (Jo-Ekspres + Ekspres)** ishte 872 mijë objekte duke shënuar rritje me 18% në krahasim me T4 2025 dhe rritje të konsiderueshme me 28% në krahasim me T1 2025. Objektet ndërkombëtar hyrëse Jo-SHU shënuan rritje të konsiderueshme prej 118% në krahasim me T1 2025.

Numri i objekteve postare Jo-SHU (Jo-ekspres dhe ekspres) të trajtuar nga OTSHP-të në T1 2026 ishte rreth 2.1 milion objekte në total, që përbën një rënie me 1% në krahasim me T4 2025, por rritje me 32% në krahasim me T1 2025.

Numri i objekteve postare Letër të OTSHP-ve në T1 2026 ishte 165 mijë objekte, që përbën një rënie me 12% në krahasim me T4 2025, por me rritje prej 10% në krahasim me T1 2025.

Numri i objekteve postare Pako të OTSHP-ve në T1 2026 ishte 1.9 milion, që përbën pothuajse të njëjtën vlerë në krahasim me T4 2025 por rritje me 34% kundrejt T1 2025. Pakot ndërkombëtare hyrëse shënuan rritjen më të madhe me 19% në krahasim me T4 2025 dhe me 122% në krahasim me T1 2025.

Struktura e objekteve postare të OTSHP-ve në T1 2026 ishte 92% pako dhe 8% letra, me rritje prej 1 dhe 1.6 pp të proporcionit të pakove në krahasim me T4 2025 dhe T1 2025 respektivisht. Në T1 2026, rreth 56% e totalit të pakove të OTSHP-ve ishin pako brenda vendit, 43% pako ndërkombëtare hyrëse, dhe vetëm 1% pako ndërkombëtare dalëse.


Pjesët e tregut e Postës Shqiptare në volumnin e përgjithshëm të shërbimeve postare (SHU+Jo-SHU) në T1 2026:

- 69% për volumnin e përgjithshëm të shërbimeve postare;
- 79% për objektet postare brenda vendit;
- 48% për objektet postare ndërkombëtare dalëse;
- 8% për objektet postare ndërkombëtare hyrëse.

Tabela 1: Ecuria e volumit të përgjithshëm dhe strukturës së shërbimeve postare¹

Ref.	Shërbimi/Perioda	T4_2023	T1_2024	T2_2024	T3_2024	T4_2024	T1_2025	T2_2025	T3_2025	T4_2025	T1_2026	Ndryshimi TmT	Ndryshimi VmV
I. Numri i objekteve postare												%	%
1	Volumi i Përgjithshëm (PSH+ OTSHP)	6,019,463	6,147,383	6,667,394	6,660,683	5,896,692	5,582,656	7,899,713	6,495,813	6,775,720	6,797,918	0%	22%
1.1	Postë brenda vendit	5,685,664	5,847,645	6,137,160	6,234,917	5,367,766	4,727,859	5,814,970	5,636,658	5,902,541	5,827,648	-1%	23%
1.2	Postë ndërkombëtare	333,799	299,738	530,234	425,766	528,926	854,797	2,084,743	859,155	873,179	970,270	11%	14%
2	Shërbim Universal Postar (PSH)	4,705,952	4,886,419	5,311,919	5,073,620	4,018,754	3,784,061	4,803,231	4,312,142	4,393,578	4,443,236	1%	17%
2.1	Postë brenda vendit	4,522,704	4,727,732	4,942,119	4,844,980	3,797,950	3,611,633	4,469,539	4,162,338	4,259,974	4,344,500	2%	20%
2.2	Postë ndërkombëtare	183,248	158,687	369,800	228,640	220,804	172,428	333,692	149,804	133,604	98,736	-26%	-43%
3	Shërbim JoUniversal Postar (Ekspres+Jo-Ekspres) (PSH+OTSHP)	1,313,511	1,260,964	1,355,475	1,587,063	1,877,938	1,798,595	3,096,482	2,183,671	2,382,142	2,354,682	-1%	31%
3.1	Postë brenda vendit	1,162,960	1,119,913	1,195,041	1,389,937	1,569,816	1,116,226	1,345,431	1,474,320	1,642,567	1,483,148	-10%	33%
3.2	Postë ndërkombëtare	150,551	141,051	160,434	197,126	308,122	682,369	1,751,051	709,351	739,575	871,534	18%	28%
II. Përqindje e volumit të shërbimeve/objekteve postare													
4	Volumi i Përgjithshëm (PSH+OTSHP)											pp	pp
4.1	Postë brenda vendit/Totalit (1.1/1)	94%	95%	92%	94%	91%	85%	74%	87%	87%	86%	-1.39	1.04
4.2	Postë ndërkombëtare/Totalit (1.2/1)	6%	5%	8%	6%	9%	15%	26%	13%	13%	14%	1.39	-1.04
5	Shërbim Universal Postar / Volumi i Përgjithshëm (2/1)	78%	79%	80%	76%	68%	68%	61%	66%	65%	65%	0.52	-2.42
5.1	SHU brenda vendit (2.1/1.1)	80%	81%	81%	78%	71%	76%	77%	74%	72%	75%	2.38	-1.84
5.2	SHU ndërkombëtare (2.2/1.2)	55%	53%	70%	54%	42%	20%	16%	17%	15%	10%	-5.12	-10.00
6	Shërbim JoUniversal Postar (Jo-Ekspres+Ekspres)/Volumi i Përgjithshëm (PSH+APOs)	22%	21%	20%	24%	32%	32%	39%	34%	35%	35%	-0.52	2.42
3.1	JO-SHU Brenda vendit (3.1/1.1)	20%	19%	19%	22%	29%	24%	23%	26%	28%	25%	-2.38	1.84
3.2	JO-SHU Ndërkombëtare (3.2/1.2)	45%	47%	30%	46%	58%	80%	84%	83%	85%	90%	5.12	10.00

Figura 1: Ecuria e numrit total të objekteve postare: brenda vendit dhe ndërkombëtare



¹ “Ndryshimi TmT” tregon ndryshimin ndaj tremujorit paraardhës, ndërsa “Ndryshimi VmV” ndaj të njëjtit tremujor të vitit paraardhës. Për treguesit e shprehur në përqindje, këto ndryshime paraqiten në pp (pikë përqindje).

Figura 2: Objektet postare sipas ofruesve të shërbimit






Figura 3: Struktura e objekteve postare sipas shërbimeve



3.Treguesi të Shërbimit Universal Postar

Tabela 2: Ecuria dhe struktura e objekteve të SHU T1 2025-T1 2026

Ref.	Shërbim Universal Postar	T1 2025	T2 2025	T3 2025	T4 2025	T1 2026	Ndryshimi TmT	Ndryshimi VmV
I.Numri i objekteve postare							%	%
A	Shërbim universal postar (Total)	3,784,061	4,803,231	4,312,142	4,393,578	4,443,236	1%	17%
A1	Postë brenda vendit	3,611,633	4,469,539	4,162,338	4,259,974	4,344,500	2%	20%
I	Objekte të thjeshta	2,759,969	3,624,314	3,411,915	3,492,953	3,481,130	0%	26%
II	Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta	851,664	845,225	750,423	767,021	863,370	13%	1%
A2	Postë ndërkombëtare	172,428	333,692	149,804	133,604	98,736	-26%	-43%
A.2.1	Objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit	26,424	231,609	58,949	47,735	24,720	-48%	-6%
I	Objekte të thjeshta	3,596	20,477	34,963	16,537	4,310	-74%	20%
II	Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta	22,828	211,132	23,986	31,198	20,410	-35%	-11%
A.2.2	Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri	146,004	102,083	90,855	85,869	74,016	-14%	-49%
I	Objekte të thjeshta	75,792	56,050	42,100	40,367	33,575	-17%	-56%
II	Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta	70,212	46,033	48,755	45,502	40,441	-11%	-42%
II Peshë në përqindje ndaj totalit të SHU							pp	pp
	Postë Brenda Vendi (A1/A)	95%	93%	97%	97%	98%	0.82	2.33
	Postë Nderkombetare (A2/A)	5%	7%	3%	3%	2%	-0.82	-2.33
	Objekte të thjeshta	75%	77%	81%	81%	79%	-1.60	4.16
	Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta	25%	23%	19%	19%	21%	1.60	-4.16



4.Tregues të shërbimit jo-universal postar (Ekspres dhe Jo-Ekspres)

Tabela 3: Ecuria dhe struktura e volumit të shërbimit jo-universal postar (Jo-Ekspres dhe Ekspres)

Ref.	Shërbimi/Periudha	T1_2025	T2_2025	T3_2025	T4_2025	T1_2026	Ndryshimi TmT %	Ndryshimi VmV %
I.Numri i objekteve postare								
1	Shërbim JoUniversal Postar (Jo-Ekspres + Ekspres) (PSH+OTSHP)	1,798,595	3,096,482	2,183,671	2,382,142	2,354,682	-1%	31%
1.1	Brenda vendit	1,116,226	1,345,431	1,474,320	1,642,567	1,483,148	-10%	33%
1.2	Ndërkombëtare	682,369	1,751,051	709,351	739,575	871,534	18%	28%
1.I	Shërbim JoUniversal Postar Jo-Ekspres	218,853	890,324	455,567	792,973	797,538	1%	264%
Form. B	Posta Shqiptare	82,974	98,724	105,974	105,141	119,694	14%	44%
B1.	Postë brenda vendit	82,661	98,502	105,661	104,992	118,159	13%	43%
B2	Postë ndërkombëtare	313	222	313	149	1,535	930%	390%
Form. D	OTSHP	135,879	791,600	349,593	687,832	677,844	-1%	399%
A.1	Postë brenda vendit	134,372	133,563	196,673	486,464	425,448	-13%	217%
A.2	Postë ndërkombëtare	1,507	658,037	152,920	201,368	252,396	25%	16648%
1.II	Shërbim Ekspres	1,579,742	2,206,158	1,728,104	1,589,169	1,557,144	-2%	-1%
Form. B	Posta Shqiptare	134,278	134,099	138,801	167,661	150,008	-11%	12%
C.1	Ekspres brenda vendit	129,139	129,356	133,984	161,871	145,439	-10%	13%
C.2	Ekspres ndërkombëtare	5,139	4,743	4,817	5,790	4,569	-21%	-11%
Form.D	OTSHP	1,445,464	2,072,059	1,589,303	1,421,508	1,407,136	-1%	-3%
B.1	Ekspres brenda vendit	770,054	984,010	1,038,002	889,240	794,102	-11%	3%
B.2	Ekspres ndërkombëtare	675,410	1,088,049	551,301	532,268	613,034	15%	-9%
II.Pesha në përqindje e volumit të shërbimeve/objekteve postare							pp	pp
2	Shërbim JoUniversal Postar (Jo-Ekspres + Ekspres)							
2.1	Brenda vendit (1.1/1)	62%	43%	68%	69%	63%	-5.97	0.93
2.2	Ndërkombëtare (1.2/1)	38%	57%	32%	31%	37%	5.97	-0.93
3	Shërbim JoUniversal Postar Jo-Ekspres (1.I/1)	12%	29%	21%	33%	34%	0.58	21.70
4	Shërbim Ekspres (1.II/1)	88%	71%	79%	67%	66%	-0.58	-21.70

Tabela 4: Ecuria dhe struktura e objekteve postare të OTSHP-ve: Letër dhe Pako

OTSHP Letra V Pako	T1 2025	T2 2025	T3 2025	T4 2025	T1 2026	Ndryshimi TmT	Ndryshimi VmV
Letra Total	150,786	615,982	182,704	188,300	165,178	-12%	10%
Letra Brenda Vendit	132,445	130,202	163,816	169,155	146,721	-13%	11%
Letra Ndërkombëtare Dalëse	7,023	253,161	6,964	7,052	6,863	-3%	-2%
Letra Ndërkombëtare Hyrëse	11,318	232,619	11,924	12,093	11,594	-4%	2%
Pako Total	1,430,557	2,247,677	1,755,629	1,920,223	1,919,242	0%	34%
Pako Brenda Vendit	771,981	987,371	1,070,296	1,205,732	1,072,269	-11%	39%
Pako Ndërkombëtare Dalëse	287,545	24,263	26,766	22,356	23,492	5%	-92%
Pako Ndërkombëtare Hyrëse	371,031	1,236,043	658,567	692,135	823,481	19%	122%
Total Objekte postare	1,581,343	2,863,659	1,938,333	2,108,523	2,084,420	-1%	32%
Pako Total/Objekte Postare Total	90%	78%	91%	91%	92%	1.0	1.6

Figura 6: Ecuria dhe struktura e volumit të shërbimit jo-universal postar (Jo-Ekspres dhe Ekspres)





Figura 7: Struktura e objekteve postare të OTSHP-ve: Letër v Pako



Aneks 1: Numri i Objekteve postare sipas ofruesve të shërbimit postar

Tabela më poshtë paraqet numrin e objekteve postare sipas raportimeve të 25 ofruesve të shërbimit postar për T1 2026, të detajuar në objekte postare brenda vendit, ndërkombëtare dalëse dhe ndërkombëtare hyrëse.

Tabela 5: Numri dhe struktura e objekteve postare sipas ofruesve të shërbimit postar (T1 2026)

Nr.	Ofruesi i shërbimit postar	Volumi i përgjithshëm	Postë Brenda Vendi	Postë Nderkombëtare Dalese	Postë Nderkombëtare Hyrese
	Totali i Raportuar T1 2026	6,797,918	5,827,648	58,933	911,337
1	Posta Shqiptare sh.a.	4,712,938	4,608,098	28,578	76,262
2	Albanian Delivery Express sh.p.k.	644,181	397,431	3,741	243,009
3	Ultra C.E.P. sh.p.k.	441,214	190,562	-	250,652
4	United Transport sh.p.k. (Uni Trans)	233,902	138,255	1,002	94,645
5	POSTMAN sh.p.k	132,971	12,628	-	120,343
6	BIPEX sh.p.k.	119,734	42,093	6,335	71,306
7	ADEX shpk	109,218	104,147	307	4,764
8	Elite Post sh.p.k.	78,235	78,235	-	-
9	Ulysses Enterprises sh.p.k.(Fedex)	64,919	51,908	1,230	11,781
10	GED sh.p.k. (ish B.E.D. sh.p.k.)	49,889	49,889	-	-
11	Mr. COURIER sh.p.k.	49,277	49,277	-	-
12	EXPRESS ALB 24 sh.p.k.	46,236	46,236	-	-
13	INTEX COURIER sh.p.k.	42,630	25,050	4,200	13,380
14	DHL International (Albania) sh.p.k.	39,443	979	13,484	24,980
15	POSTA JONË sh.p.k.	14,316	14,316	-	-
16	T.N.T Express Albania sh.p.k.	10,306	10,256	50	-
17	Greenposta shpk	5,804	5,804	-	-
18	Tribex Courier	2,041	2,041	-	-
19	PIKPAK	443	443	-	-
20	German Traum	215	-	-	215
21	Air Cargo Service sh.p.k. (A.C.S.)	6	-	6	-
22	Top Post sh.p.k.	-	-	-	-
23	Youth Albania Professional Services	-	-	-	-
24	Milsped Albania sh.p.k.	-	-	-	-
25	M-ONE ALBANIA sh.p.k	-	-	-	-

Shënime:

Objektet postare në këtë tabelë përfshijnë të gjitha llojet e objekteve postare (letër, pako, etj.), objekte të thjeshta dhe të regjistruara, pjesë e objektit të Shërbimit Universal, shërbimit jo universal, përfshirë shërbimin ekspres etj..

Të dhëna statistikore kanë raportuar 25 subjekte nga 26 subjekte të Regjistrimit AP me detyrim raportimi për T1 2026: Posta Shqiptare sh.a dhe 24 ofrues të tjerë të shërbimit postar (OTSHP), ndërsa 1 subjekt (IPOST sh.p.k) nuk ka raportuar sipas formularëve të Rregullores (në proces cregjistrimi nga Regjistri i AP).

Aneks 2: Terma dhe shkurtime dhe përshkrimi i treguesve

Treguesi	Referenca në Formularë (Rreg.40/2015)	Përshkrim/Sqarim
Shërbim Universal (SHU)	Form. B, Kat. A.	Shërbim Universal postar është një minimum i përcaktuar shërbimesh, të një cilësie të caktuar, i mundshëm për të gjithë përdoruesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, me çmime të përballueshme, sipas përcaktimeve në Ligjin 46/2015 dhe aktet përkatëse nën-ligjore.
Shërbim Ekspres	Form. B/Kat C, Form. D/Kat.B.	Është shërbim postar sipas përcaktimeve në Ligjin 46/2015 dhe aktet përkatëse nën-ligjore, që nuk është pjesë e shërbimit universal, dhe që ka si karakteristikë kryesore shpërndarjen e objekteve postare në një kohë të shpejtë/shkurtër ose të përcaktuar. Klasifikohet si shërbim me vlerë të shtuar dhe ka çmim më të lartë se shërbimet e tjera postare.
Shërbim Jo-Universal Postar Jo-Ekspres (Jo-SHU-Jo-Ekspres)	Form. B/Kat B, Form. D/Kat.A.	Shërbimi Jo-Universal Postar Jo-Ekspres, përfshin të gjitha shërbimet e tjera postare që nuk janë pjesë/klasifikohen si SHU si dhe njëkohësisht nuk janë Shërbim Ekspres. <i>Sqarim:</i> <i>Në formularët statistikorë të Rregullores 40/2015 të AKEP ky shërbim është kategori më vehte i referuar thjesht si Shërbim Jo-Universal (Kategoria B e Formularit B dhe Kategoria A e Formularit D)</i> <i>AKEP në këtë dokument përdor termin Shërbim Jo-Universal Postar dhe Jo-Ekspres (Jo-SHU-Jo-Ekspres) për ta dalluar nga Shërbimi Ekspres, i cili gjithashtu është Shërbim Jo-Universal.</i>
Postë brenda vendit (Domestic post)	Form. B/Kat. A1; B1; C1. Form. D/Kat. A1; B1.	Objekte postare të pranuar dhe shpërndara brenda vendit. (Pala dërguese dhe pala marrëse e objektit postar janë në Shqipëri).
Postë Ndërkombëtare Dalëse (International Outbound)	Form. B/Kat. A.2.1; B.2; C.2.I. Form. D/Kat. A.2.I; B.2.I.	Objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit (Pala dërguese në Shqipëri, pala marrëse jashtë vendit)
Postë Ndërkombëtare Hyrëse (International Inbound):	Form. B/Kat. A.2.2; C.2.II. Form. D/Kat. A.2.II; B.2.II.	Objekte postare të dërguara nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri. (Pala dërguese jashtë vendit, pala marrëse në Shqipëri)
Objekt Postar	Form. B Form. D. (Të gjithë treguesit)	Është një objekt i adresuar, në formën e tij përfundimtare, që dërgohet nga ofruesi i shërbimit postar ku, përveç objekteve të korrespondencës së letrave, përfshihen dhe librat, katalogët, gazetat, revistat dhe pakot postare që përmbajnë mallra me ose pa vlerë tregtare (Ligji 46/2015, Neni 3, pika 13)
Letër	Form D/ Kat. A.1.1; A.2.I.1 A.2.II.1;B.1.1; B.2.I.1 B.2.II.1.	Objekte të korrespondencës (komunikimi me shkrim me letër), si edhe dokumenta, shtypshkrime etj., me peshë max. 2kg.
Pako	Form D/ Kat. A.1.2; A.2.I.2 A.2.II.2;B.1.2; B.2.I.2 B.2.II.2.	Objekte postare që përmbajnë mallra me ose pa vlerë tregtare me peshë max.20kg.
OSHU/USP	Form. B	Ofrusi i Shërbimit Universal (Universal Service Provider): OSHU në Shqipëri është vetëm Posta Shqiptare (PSH).
OTSHP/OPSPs:	Form. D	Ofrues të Tjerë të Shërbimeve Postar (Other Postal Service Providers): Të gjithë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare sipas Autorizimit të Përgjithshëm, përveç Ofruesit të Shërbimit Universal (Postës Shqiptare)